

Hapet Spitali i ri Infektiv



Kryeministri Edi Rama dhe Ministrja Ogerta Manastirliu morën pjesë në ceremoninë e hapjes së Spitalit të ri Infektiv, një investim i qeverisë shqiptare, Rindërtimi i Spitalit Infektiv vjen në kuadër të planit të qeverisë për përballimin e emergjencave shëndetësore, me fuqizimin e kapaciteteve në sistemin spitalor dhe Planin e Masave për përgjigjien ndaj pandemisë Covid-19. Investimi me vlerë prej 5.6 milion euro konsistoi në rikonstruksionin dhe zgjerimin e kapaciteteve të Spitalit Infektiv. Spitali Infektiv do të jetë një qendër ekselence për sëmundjet infektive, me një staf mjekësor multidisiplinar.



NIS VAKSINIMI KUNDËR HPV

Vaksina kundër Virusit të Papiomës Humane është përfshirë në kalendarin kombëtar të vaksinimit. Fushata për vaksinimin kundër HPV nisi në ditët e para të muajit Nëntor për të gjitha vajzat e moshës 13 të lindura në vitin 2009. Ministrja Ogerta Manastirliu u shpreh se kjo vaksinë shton sigurinë për shëndetëin e vajzave për parandalimin e kancerit të qafës së mitrës dhe e përaftron kalendarin kombëtar të vaksinimit me atë evropian.

INDEKS MATËS PËR KËNAQSHMËRINË E PACIENTËVE

Prezantohet për herë të parë indeksi i kënaqshmërisë së pacientit. Faza e parë e vrojtimit të kënaqshmërisë së pacientëve konkludoi me indikacione për vetë sistemin, për të përmirësuar punën e përditshme, për të parë edhe shkallën e mbulimit shëndetësor në popullatë por edhe për kostot e shërbimeve në mënyrë që të rritet efikasiteti i shërbimit ndaj pacientit. Përcaktimi i indeksit të kënaqshmërisë së pacientit është objekti i studimit të kryer nga projekti "Shëndet për të Gjithë" për shërbimet e ofruara në sistemin e kujdesit shëndetësor parësor.



700 MIJË DOZA PËRFORCUESE TË VAKSINËS ANTI-COVID

Vaksinat e adaptuara për Shqipërinë, falë marrëveshjes së qeverisë shqiptare me kompaninë Pfizer, kanë filluar aplikimin në çdo qendër shëndetësore. Brenda muajit nëntor janë siguruar rreth 700 mijë vakcina Pfizer. Aktualisht në çdo qendër shëndetësore po kryhet falas vaksinimi kundër gripit dhe Covid19.

BUXHETI 2023: FISHAT E DIABETIT FALAS PËR TË MOSHUARIT MBI 65 VJEÇ

Gjatë prezantimit të projekt-buxhetit të vitit 2023 në Kuvend, Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Ogerta Manastirliu bëri me dije se qeveria do të financojë fishat e diabetit falas për të moshuarit mbi 65-vjeç. Pas rimbursimit të fishave të diabetit për fëmijët dhe të rinjtë deri në 25 vjeç, nga viti që vjen nis mbështetja e të moshuarëve +65 vjeç që vuajnë nga diabeti, në rimbursimin e fishave.

